

# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK

## PËR KOMUNAT E KOSOVËS

SHKURT 2016





# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK PËR KOMUNAT E KOSOVËS

SHKURT 2016





COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>8</b>
<b>QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE .....</b>	<b>10</b>
<b>TRANSPARENCA BUXHETORE .....</b>	<b>13</b>
<b>TRANSPARENCA NË PROKURIM .....</b>	<b>16</b>
<b>TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE .....</b>	<b>21</b>
<b>KONKLUZIONE.....</b>	<b>23</b>

# HYRJE

Transparenca mund të përkufizohet si qasje në informata në kohën e duhur, që është lehtësisht e kuptueshme, dhe mbron integritetin e procesit dhe interesat e të gjithë akterëve të përfshirë. Mirëpo, edhe pas shumë ndryshimeve ligjore dhe premtimeve institucionale, shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë në masë të madhe mbesin të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk janë të qasëshme nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku. Sipas raporteve të publikuara prej autoriteteve qeveritare për vitin 2014<sup>1</sup>, nga gjithsej 1,589 Milion Euro<sup>2</sup> të Buxhetit të përgjithshëm qeveritar, 445.2 Milion Euro<sup>3</sup> janë shpenzuar përmes procedurave të prokurimit. Kjo vlerë paraqet 28% të vlerës së përgjithshme të buxhetit. Prokurimi publik paraqet një mundësi për të bërë një ndryshim apo për të ushtruar një ndikim në një nivel të caktuar, komunitet apo edhe rreth më të gjerë, dhe nuk ka të bëjë vetëm me blerjen e mallrave apo shërbimeve, por edhe me menaxhimin e këtyre kontratave, përputhshmëri ligjore, trajtim të drejtë, transparencë e llogaridhënie. Për çdo Euro që mund të kursehet gjatë procesit të prokurimit publik, janë një Euro më shumë që mund të shfrytëzohet për të përmirësuar kushtet aktuale të vendit, apo ndihmuar ata që kanë nevojë.

Sipas Cobus de Swardt, Drejtor Menaxher i Transparency International: “Kur produktet që, në fund të fundit, qytetarët paguajnë për to janë të rrezikshme, të papërshtatshme apo të kushtueshme do të jetë një humbje e pashmangshme e besimit të publikut në qeveri”. OECD vlerëson se korrupsioni në nivelet institucionale thith rreth 20-25 për qind të buxheteve qeveritare të prokurimit publik, dhe 57 për qind e ras-

teve të rryshfetit, të ndjekura nga Konventa e OECD Kundër Mito-marrjes përfshijnë rryshfete të pranuar përmes kontratave publike.<sup>4</sup>

Në parim, ciklet transparente dhe të përgjegjshme të prokurimit do të thotë se kompanitë që fitojnë ofertat janë ato me produktin më të mirë, me çmim të mirë, me plan dhe qëllim që të arrijnë rezultatin më të mirë.

Informacioni duhet të jetë në dispozicion mënyrë pro aktive i ditur që nga vendimet më të hershme deri në auditimet e fundit. Vlerësimi i nevojave, buxhetet, njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratës, planifikimet e prokurimit, ankandet, etj., duhet të jenë të publikuara në mënyre pro aktive, dhe në fazat sa më të hershme, që publiku të jetë i njoftuar dhe i përgatitur lidhur me atë se ku dhe si po shpenzohen taksat e tyre.

Shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë janë në masë të madhe të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk ka qasje dhe mbikëqyrje të duhur nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku. Për këtë arsye Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK) është angazhuar që të përgatisë këtë Indeks të Transparencës në Prokurimin Publik. Synimi i këtij indeksi është që të bëhet presion tek institucionet që të ofrojnë transparencë më të lartë dhe qeverisje më të hapur. Qasja në informacion lidhur me shpenzimet publike përmes prokurimit publik do t'i mundësonte publikut të njihen më mirë se ku shkojnë taksat e tyre. Njëkohësisht transparenca më e madhe parandalon parregullsitë, keq-menaxhimin dhe korrupsionin në këto institucione.

1 Per krahasim janë marr publikimet e vitit 2014, meqe publikimet për vitin 2015 janë edhe në përpunim nga Institucionet përkatëse

2 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

3 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2014/Raportet%20Vjetore%202014%20Shqip%20KRPP.pdf>

4 <http://www.oecd.org/corruption/oecd-foreign-bribery-report-9789264226616-en.htm>





## TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE:

- 14 Njoftimet për shpallje të ankandit publik në ueb faqe;
- 15 Njoftime për shpallje të ankandit në ueb faqe të KRPP;
- 16 Njoftim për fituesit e ankandit në ueb faqe;
- 17 Njoftim për fituesit e ankandit në ueb faqe të KRPP.

të bërë në vitin 2014 kanë treguar që ky korrelacion nuk është prezent. Për këtë arsye ky indikator është larguar nga matjet për vitin 2015. Megjithatë, komunat që gjenden në pjesën veriore të Kosovës, kanë të njëjtat trende sikurse komunat tjera në filllet e funksionimit të tyre dhe vërehet një mungesë e ankesave në OSHP nga operatorët ekonomikë që konkurrojnë për kontrata në këto komuna.

Në kuadër të këtij monitorimi KDI në vazhdimësi do të masë nivelin e publikimit të dokumenteve të cilat lidhen me transparencën në fushën e prokurimit publik. Mbledhja e të dhënave është bërë në dhjetor të vitit 2015. Katër komuna të Kosovës që gjenden në pjesën veriore nuk kanë uebfaqe funksionale.

Gjatë analizës së vitit 2014<sup>5</sup>, KDI ka matur gjithashtu trendin e ankesave në OSHP. Në filllet e funksionimit të institucioneve niveli i ulët i ankesave në OSHP ka shpërfaqë nivel të lartë të korrupsionit në institucione. Operatorët ekonomikë janë kërcënuar që të mos parashtrojnë ankesa. Mirëpo, gjetjet e matjes së fundit

5 <http://kdi-kosova.org/publikime/42-2014-12-09-indeksi-i-tranparences-ne-prokurimin-publik-ne-komuna-alb.pdf>





## NUMRI I KËRKESAVE PËR QASJE TË DËRGUARA NGA KDI TEK KOMUNAT DHE PËRGJIGJET NË KËRKESA

**38**

KOMUNA



**3**


NUK KANË KONTAKTE

**35**

KËRKESA PËR QASJE TË DËRGUARA

**9**

NUK JANË PËRGJIGJUR NË KËRKESA



**26**

JANË PËRGJIGJUR NË KËRKESA

### LISTA E KOMUNAVE QË NUK KANË KTHYER PËRGJIGJE

1 DRENAS

4 KAÇANIK

7 PARTESH

2 FUSHË KOSOVË

5 KLLOKOT

8 RANILLUG

3 JUNIK

6 NOVO BËRDË

9 SHTËRPCË







# TRANSPARENCA BUXHETORE

Një nga nënfushat më të rëndësishme të administrimit publik është Buxheti. Përmes buxhetit, qeveritë ndajë burimet e tyre, programet dhe shërbimeve për mirëqenien e qytetarëve të tyre, prandaj ky është një nga veprimet më të rëndësishme si në nivelin qendror edhe në atë lokal, në bazë të së cilit merren vendime shumë të rëndësishme.

Në këtë shtyllë KDI ka matur transparencën buxhetore të komunave, e cila domosdoshmërisht lidhet edhe me prokurimin publik duke pasur parasysh se shumica e planifikimeve buxhetore realizohen përmes prokurimit për investime kapitale si dhe të shërbimeve apo mallrave.

Për të krahasuar transparencën buxhetore, KDI ka shfrytëzuar indikatorët e mëposhtëm:

- 1 Publikimi i buxhetit në ueb faqe
- 2 Plani i prokurimit në ueb faqe
- 3 Raporti i auditorit në ueb faqe
- 4 Numri i dëgjimeve publike 2015
- 5 Numri i raporteve të shpenzimeve financiare janar- dhjetor 2015

## PUBLIKIMI I BUXHETIT NË UEB FAQE

Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm i komunës jo vetëm për prokurimin publik por për transparencën në përgjithësi. Në këtë shtyllë ne kemi gjetur të dhënat shqetësuese. Në periudhën janar deri më dhjetor 2015,

50% e komunave nuk kishin publikuar buxhetin komunal në ueb faqet e tyre. Nga 38 komuna, vetëm 19 kishin publikuar buxhetin që tregon një rritje të transparencës prej vetëm 5% krahasuar me vitin paraprak. Publikimi i buxhetit ndihmon qytetarët që të shohin se si bëhet shpenzimi i buxhetit që është mbledhur me taksat e tyre. Përmes buxhetit qytetarët do ta kuptojnë nëse rruga, lagjja apo bashkësia territoriale e tyre do të jetë pjesë e planeve të të zgjedhurve të tyre. Përmes transparencës në buxhet qytetarët lehtësisht mund të informohen për çdo investim që do të bëhet në komunën e tyre. Kjo njëkohësisht do të ndihmonte ndërmarrësit se si do të mund të participonin në proceset e prokurimit publik.



## PLANIFIKIMET E PROKURIMIT NË UEB FAQE

Plani i prokurimit vjen si rrjedhojë e planifikimeve për prokurim, i cili është një proces i marrjes së vendimeve se çfarë produktesh duhet blerë, apo cilat shërbime duhet





kontraktuar, për përmbushjen e detyrave zyrtare në shërbim të qytetarit, i cili përfundimisht paguan këto shërbime përmes sistemit të taksave. Gjatë procesit të planifikimit të prokurimit përcaktohet metoda e prokurimit si dhe përcaktohen pritjet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Planifikimet e prokurimit janë të rëndësishme sepse liston të gjitha kërkesat e pritshme që do të prokurohen gjatë një periudhe, jep një afat kohor të realizimit të këtyre prokurimeve, si dhe parashikimet e vlerës së prokurimeve. Përveç që ky planifikim ofron mundësinë e konsolidimit të prokurimit të artikujve të ngjashëm apo interesit të përbashkët, ai jep një mundësi ndërmarrësve që të bëjnë planifikimet dhe përgatitjet e nevojshme për qasje në prokurim publik, si dhe që ofertat e tyre të jenë sa më konkurruese. Sipas legjislacionit paraprak, i cili ishte në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, Publikimi i Planifikimit të Prokurimit ishte i ndaluar nën pretekstin se publikimi i vlerave të parapara të prokurimeve do të humbiste vlerën e tregut, dhe Operatorët Ekonomik do të ofertonin çmime sa më të përafërta me vlerat e parashikuara buxhetore. Megjithatë, nga 38 Komunitet e vlerësuar, gjashtë komuna janë treguar pro aktive, duke publikuar planet e prokurimit në formë të njoftimit paraprak, apo me çmime të larguara.



Në krahasim me indeksin e transparencës për vitin 2014, në vitin 2015 kemi një rritje prej 16% meqë vitin paraprak nuk kishte asnjë planifikim të prokurimit të publikuar në faqet e komunave.

## RAPORTI I AUDITORIT NË UEB FAQE

Publikimi i raportit të auditimit për vitin 2015 është një tjetër indikator me rëndësi, pasi në këtë formë i ofron publikut të dhëna se si janë menaxhuar paratë publike nën menaxhimin e komunës.

Në krahasim me indeksin e vitit të kaluar, në këtë indikator shohim një rritje prej 3%, nga 18% për 2014 në 21% në vitin 2015. Megjithatë pjesa më e madhe ende nuk i publikojnë raportet e auditimit në ueb faqet e tyre.

Duhet të ceket se raportet e auditimit për të gjitha komunat gjenden në faqen e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Megjithatë, komunat duhet të ju ofrojnë qytetarëve mekanizma shtesë të informimit rreth raporteve të tilla që kanë synim komunat e tyre.

Mungesa e pasqyrit të raporteve të tilla në ueb faqet e komunave paraqet vështirësi për qytetarët në gjetjen e tyre duke pa mundur qytetarëve qasje në informata të mjaftueshme mbi raportet e auditorit të përgjithshëm dhe mbi gjitha mbi mënyrën e realizimit dhe shpenzimit të taksave në komunat përkatëse. Nëse komunat nuk publikojnë raportin e auditimit për komunën e tyre në ueb faqen zyrtare, të paktën mund të ofrojnë një lidhëz se ku mund të gjendet raporti i tillë.



## NUMRI I DËGJIMEVE PUBLIKE 2015

Për sa i përket dëgjimeve publike, Komunat janë treguar mjaft aktive në këtë drejtim. 26 Komunat të cilat i janë përgjigjur kërkesës për qasje në dokumente publike, kemi 125 dëgjime publike, nga të cilat komunat e Prizrenit dhe Obiliqit kanë qenë më aktivet me nga 10 dëgjime publike. Tabela në vijim paraqet gjashtë komunat më aktive.

Komuna	Nr. I degjimeve publike 2015
Pejë	16
Lipjan	15
Prizren	10
Obiliq	10
Prishtinë	9
Mitrovicë	9
Vushtri	9
Shtime	8

## NUMRI I RAPORTEVE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE JANAR- DHJETOR 2015

Në krahasim me vitin 2014, shohim se kemi një vetëdijesim nga ana e komunave lidhur me publikimin e raporteve të shpenzimeve financiare. Kemi 43 raporte tremujorshe, gjashtë mujorshe apo vjetore të publikuara në 21 ueb faqe të komunave.

Komuna	Nr. I raporteve të shpenzimeve financiare Janar - Dhjetor 2015
Deçan	0
Dragash	0
Drenas	0
Ferizaj	0
Fushë Kosovë	0
Gjakovë	1
Gjilan	1
Graçanicë	1
Hani i Elezit	4
Istog	3
Junik	0
Kaçanik	3
Kamenicë	1
Klinë	1
Kllokot	0
Lipjan	3
Malishevë	4
Mamushë	0
Mitrovicë	1
Mitrovicë e Veriut	0
Novo Bërdë	3
Obiliq	0
Partesh	0
Pejë	3
Podujevë	3
Prishtinë	3
Prizren	0
Rahovec	4
Ranillug	1
Shtërpcë	0
Shtime	2
Skenderaj	1
Suharekë	1
Viti	1
Vushtri	4
Leposaviq	0
Zubin Potok	0
Zvecan	0
<b>Total</b>	<b>48</b>





prokurimit publik në ueb faqet e tyre përkatëse, ose e kanë të pa azhurnuar për një kohë shumë të gjatë.

Publikimi i njoftimeve në ueb faqe të komunës është i rëndësishëm për bizneset lokale dhe qytetarët e komunës të cilët mbase do të kishin një ide më të saktë se në çka është duke investuar komuna e tyre, me çfarë çmimi dhe me cilët operatorë ekonomik.



Nga 2,204 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 1,087 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave apo në përqindje vetëm 49% e tenderëve janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave përkatëse.

Duke i krahasuar këto vlera me Indeksin e Transparencës në Prokurim Publik për Komunitet e Kosovës, për vitin 2014, shohim se kemi një përmirësim të nivelin e

transparencës ku nga 31% për vitin 2014, kemi një rritje prej 18%, respektivisht në 49% për vitin 2015.

Duke u bazuar në tabelën e më poshtme, komunat e Drenasit, Gjakovës, Kaçanikut dhe Novobërdës tregojnë një pro aktivitet në publikimin e njoftimeve për kontratë, duke kaluar edhe vlerën 100% si rrjedhojë e publikimit të njoftimeve për kuotim dhe blerjet me vlerë minimale, të cilat nuk ishin të obliguara për publikim në ueb faqen e KRPP-së nga Ligji 04/L-042 për Prokurim Publik. Gjatë krahasimit të publikimeve të njoftimeve për kontratë, rezultojnë se gjashtë komunat më transparente në këta dy indikatorë janë si në tabelën në vijim:

## NJOFTIMET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Për sa i përket njoftimeve për dhënie të kontratës, nga 2,944 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 1,008 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave apo në përqindje vetëm 34% e fituesve të kontratave janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave përkatëse.

Duke i krahasuar këto vlera me Indeksin e Transparencës në Prokurim Publik për Komunitet e Kosovës, për vitin 2014, shohim se kemi një përmirësim të nivelin e transparencës ku nga 20% për vitin 2014, kemi një rritje prej 14%, respektivisht në 34% për vitin 2015.

#	Komuna	Nr.i tenderëve të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2015	Nr. i tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP për 2015	%
1	Drenas	120	83	145%
2	Gjakovë	132	102	129%
3	Kaçanik	48	40	120%
4	Novo Bërdë	22	19	116%
5	Prishtinë	323	326	99%
6	Istog	71	82	87%

INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK

|||||

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, respektivisht Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik A02 të KRPP-së, kërkon që të gjitha njoftimet për dhënie të kontratës (fituesit e tenderëve), për të gjitha vlerat, pos atyre minimale (0.01-1,000.00 €) brenda afatit dy (2) ditore të publikohen në ueb faqen e KRPP-së. Në rastet e Komunave të Gjakovës dhe Kaçanikut, kemi një vlerë mbi 100% të publikimeve në ueb faqet e komunave krahas asaj të KRPP-së si rrjedhojë e duplikimeve, dhe

mungesës së publikimeve të disa dhënies të kontratës me procedura të kuotimit, që vijnë si pasojë e keqkuptimit ndërmjet rregullave për publikimet e njoftimeve për kontratë dhe atyre për dhënie të kontratës.


Gjatë krahasimit të publikimeve të njoftimeve për kontratë, rezulton se gjashtë komunat më transparente në publikimin e njoftimeve për dhënie të kontratës janë:

#	Komuna	Nr. i fituesve të tenderëve në ueb faqen e komunës Janar-dhjetor 2015	Nr. I fituesve të tenderëve në ueb faqen e KRPP Janar - dhjetor 2015	%
1	Gjakovë	96	64	150%
2	Kaçanik	59	57	104%
3	Prishtinë	284	288	99%
4	Drenas	129	131	98%
5	Istog	87	94	93%
6	Gjilan	76	94	81%

|||||




## KRAHASIMI I PUBLIKIMIT TË TENDERËVE PËR TË GJITHA KOMUNAT





## KRAHASIMI I PUBLIKIMIT TË FITUESVE PËR TË GJITHA KOMUNAT



# TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE

## NJOFTIM PËR SHITJE TË ASETVE

Në krahasim me numrin e prokurimeve publike, numri i ankandeve është shumë më i vogël dhe artikujt të cilët shiten përmes ankandeve nuk kanë vlera të mëdha, prapë se prapë ne kemi dashur të matim publikimin e njoftimeve për këto ankande.

Katër indikatorët që janë krahasuar për të parë dallimin e njoftimeve në mes të ueb faqeve të komunave përkatëse dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së janë:

- 6** Numri i njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2015
- 7** Numri i njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e KRPP
- 8** Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2015
- 9** Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP janar - dhjetor 2015

Nga të dhënat e mbledhura nga ueb faqet e komunave dhe atë të KRPP-së, shohim se numri i publikimeve të njoftimeve për Ankande si dhe njoftimeve për dhënie të kontratës nuk është i madh. Ajo që është shqetë-

suese është se transparencja komunale në këta indikator është shumë e vogël. Meqë publikimi i Ankandeve në ueb faqe të KRPP-së është një detyrim ligjor, për vitin 2015, kemi 77 njoftime për Ankande në ueb faqe të KRPP-së, por vetëm 8 prej tyre janë të publikuara në ueb faqet e komunave, që do të thotë se transparencja në njoftim të Ankandeve është vetëm 10%.



Në krahasim me publikimet e bëra për vitin 2014, vërejmë se gjatë vitit 2015 kemi një rritje prej 48% të njoftimeve në ueb faqen e KRPP-së, mirëpo në anën tjetër kemi një ulje të transparencës komunale për 42%.

Tri komunat e vetme që kanë treguar transparencë në procesin e publikimit të njoftimeve të ankandeve janë si në vijim:



#	Komuna	Nr. i njoftimeve në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2015	Nr. i njoftimeve të publikuar në ueb faqen e KRPP janar-dhjetor 2015	%
1	Novo Bërdë	5	6	83%
2	Istog	1	2	50%
3	Viti	2	7	29%

## NJOFTIM PËR DHËNIE KONTRATE

Pothuajse të njëjtën situatë kemi edhe me publikimet për dhënie të kontratës përmes Ankandeve publike, ku niveli i transparencës komunale është vetëm 11% në krahasim me publikimet në ueb faqe të KRPP-së.

Në krahasim me publikimet e bëra për vitin 2014, vërejmë se gjatë vitit 2015 nuk kemi ndryshim në rritjen e transparencës për sa i përket njoftimeve për shitje të aseteve në ueb faqen e KRPP-së, mirëpo në anën tjetër kemi një rritje prej 50% për sa i përket publikimeve në ueb faqen e KRPP-së.

Tri komunat e vetme që kanë treguar transparencë në procesin e publikimit të njoftimeve të shitjeve përmes ankandeve janë si në vijim:



#	Komuna	Nr. i fituesve të ankandeve në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2015	Nr. i fituesve në ueb faqen e KRPP janar-dhjetor 2015	%
1	Viti	2	2	100%
2	Novo Bërdë	2	3	67%
3	Istog	1	2	50%



# KONKLUZIONE

## TË PËRGJITHSHME

Vërehet një trend pozitiv i rritjes së transparencës së dokumenteve të publikuara nga komunat që kanë të bëjnë më prokurimin publik.

Mungon një pasqyrë e qartë e planifikimit, konsultimit me qytetarë dhe publikimit të shpenzimeve të komunave në Kosovë.

Uebfaqet e komunave nuk kanë konsistencë dhe qartësi në prezantimin e informacioneve dhe dokumenteve që lidhen me shpenzimet e tatimeve dhe taksave të qytetarëve.

Shumë komuna nuk e kanë përmbushur kushtin ligjor të mbajtjes së takimeve me qytetarë duke iu mohuar kështu atyre të drejtën për të qenë të informuar me projektet dhe planet e komunës në të cilën jetojnë dhe kontribuojnë si taksapagues.

Të dhënat e gatshme që përgatiten nga komunat sikurse njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënie kontrate, lehtësisht mund të publikohen në uebfaqet e komunave. Gjithashtu, raportet e Auditorit të Përgjithshëm dhe buxheti i publikuar nga thesari janë gjithashtu të dhëna që janë të gatshme për publikim në uebfaqe të komunave. Ato të dhëna shumë lehtë mund të përdoren për të pasuruar uebfaqet e vetë komunave pa shpenzuar kohë dhe resurse tjera.

## QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Ndonëse disa komuna nuk kanë bërë të ditur numrin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike për 2015, krahasuar me 2014, është shënuar rritje substanciale e numrit të kërkesave të parashtruara në

komuna. Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për vitin 2014 në 34 komuna ishte 492, kjo shifër është ngritur në 699 në vitin 2015, që shënon një rritje prej 30%.

Në vitin 2014, në 34 komuna u parashtruan 116 kërkesa për qasje në dokumente publike në prokurim publik. Ky numër në vitin 2015 është ngritur në 169, që shënon gjithashtu një rritje të kërkesave për 31%.

Këta dy indikatorë tregojnë që interesimi i publikut, gazetarëve apo bizneseve për informacion nga komunat mbi procesin e prokurimit publik është në rritje.

## TRANSPARENCA BUXHETORE

Edhe pse në disa nga indikatorët, Komunitat e Kosovës kanë treguar një rritje në krahasim me vitin 2014, në përgjithësi Komunitat ende ushtrojnë një transparencë shumë të ulët buxhetore. Shumica e komunave nuk bëjnë publike dokumentet minimale të tilla si buxheti apo edhe raporti i shpenzimeve për vitin përkatës. Në uebfaqe të komunave mungojnë edhe dokumente shumë të rëndësishme për mbarrëvajtjen e prokurimit publik, siç janë planifikimet e prokurimit, apo edhe raporti i zyrës së auditorit të përgjithshëm, apo raportet e auditorit të brendshëm.

Planifikimi buxhetor me pjesëmarrje të qytetarëve (përmes mekanizmave si dëgjimet publike) do të çonte në shpenzim më efikas dhe të ekuilibruar të parasë publike nga ana e komunave. Njëkohësisht, publikimi i buxhetit në uebfaqe do t'u ofronte mundësi qytetarëve të njihen me planifikimin e shpenzimeve që do të bënte komuna. Në fund, raportet e shpenzimeve, përveç që mbështesin elementin llogaridhënës të komunave, mund t'u shërbejnë vetë komunave për të promovuar punën e tyre dhe për të zgjeruar bazën elektorale.



Në këtë shtyllë, Komunitet me transparente janë treguar ato të Vitisë, Suharekës, Prishtinës, Rahovecit, Kamenicës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Shtimes.

## TRANSPARENCA NË PROKURIM

Një numër i madh i komunave nuk publikojnë në ueb faqet e tyre njoftimet për kontratë apo njoftimet për dhënie të kontratës. Janë 13 komuna, niveli i transparencës së cilave është 0% në të dy indikatorët në fjalë. Përmes këtyre dy dokumenteve qytetarët, mediat apo edhe të interesuarit e tjerë mund të shohin se kur një institucion ka shpallur një tender dhe kush janë fituesit e tyre. Edhe pse ligjërisht kërkohet që njoftimet të publikohen në faqen e KRPP-së, shumë qytetarë e kanë më të lehtë të orientohen për informata në komunën e tyre se sa në institucionet qendrore.

Duke bërë një krahasim me nivelin e transparencës për vitin 2014, për sa i përket shtyllës së transparencës në tenderim, është evidentuar një rritje të përgjithshme prej 16%, respektivisht nga mesatarja e transparencës

25.5% për vitin 2014, në 41.5% për vitin 2015. Sado që ky hulumtim tregon një rritje të transparencës në procedurat e tenderimit dhe dhënies së kontratave, mesatarja ende mbetet nën 50% e larg nga një transparencë e plotë që do të duhej të ishte synim i çdo udhëheqjeje llogaridhënëse. Komunitet me transparente për sa i përket transparencës në prokurim janë treguar ato të Gjakovës, Drenasit, Kaçanikut, Prishtinës, Istogut dhe Gjiçanit.

## TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE

Përmes ankandëve komunitet shesin zakonisht mallra të konfiskuara apo edhe pajisje të cilat nuk janë të përdorshme nga institucioni. Sidoqoftë kjo kategori përgjithësisht vazhdon të mbetet jo-transparente për sa i përket publikimeve, dhe vullnetit të mirë që komunitet njoftojnë qytetarët e tyre për këto veprime. Komunitet me transparente në këtë shtyllë janë ato të Novo Bërdës, Vitisë dhe Istogut.





|||||

# SHTOJCA 1.

## LISTA E PYETJEVE QË U JANË DËRGUAR TË GJITHA KOMUNAVE

**PYETJA 1:** Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 2:** Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 3:** Sa është numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 4:** Sa është numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014?

**PYETJA 5:** Sa është numri i dëgjimeve publike të organizuara nga Komuna e juaj në vitin 2015, gjatë procesit të hartimit të Buxhetit për vitin 2015?

**PYETJA 6:** A publikoni në ueb faqen e juaj të dhëna të tilla si: raport të auditorit, raport të shpenzimeve, njoftim për kontratë dhe njoftim për dhënie të kontratës?

|||||

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.712(496.51)"2016"

Indeksi i transparencës në prokurimin publik për komunat e Kosovës 2016 / Instituti Demokratik i Kosovës – Prishtinë:  
Instituti Demokratik i Kosovës, 2016. – 28 f.:  
ilustr. me ngjyra; 21 cm.

**ISBN 978-9951-8927-2-8**



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy  
Pristina

